

AKTI I THEMELIMIT
i
SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“BLOOM CREATIVE” Sh.p.k.

Sot, më datë 21.022024

Znj. Marlein Topciu, e bija e Albert, e datëlindjes 13.07.1991., lindur në Durres e banues në Durrës, rruga “Pavaresia”, Plazh, Durres., identifikuar sipas ligjit me anë të Letërnjoftimit ID nr. 034274152;

Znj. Rudina Kastrati, e bija e Faton, e datëlindjes 22.03.1989, lindur në Shijak e banues në Durrës, rruga “Pavaresia”, Plazh, Durres, identifikuar sipas ligjit me anë të Letërnjoftimit ID nr. .034068280

Ka përpiluar këtë Akt Themelimi të shoqërisë tregëtare “Bloom Creative” Sh.p.k. me termat e mëposhtme.

NENI 1

Shoqëria Tregtare “Bloom Creative” Sh.p.k., themelohet në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, në përputhje me ligjin 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, (këtu e më poshtë Shoqëria).

Shoqëria është një person juridik shqiptar.

NENI 2

EMRI DHE VULA

Shoqëria do të dalë në qarkullimin juridiko-civil me emrin “**BLOOM CREATIVE**” Sh.p.k.

NENI 3

Objekti i veprimtarisë

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetet me objektin e veprimtarisë si më poshtë:

- Shërbimeve publicitare;
- Shërbime të lidhura fotografinë ushqimore;
- Shërbime agjencie publicitare të kryera për llogari të një klienti, duke përfshirë çdo negociatë, komunikim, apo veprim përgatitor që ka për objektiv dhe/ose qëllim të përfundimi i një transaksioni.



- Krijimi dhe regjistrimi i markave tregtare, zotërimi i të drejtave të markave tregtare, zotërimi i licencave dhe të drejtave për përdorimin e markave tregtare. Menaxhim i të drejtave të autorit, markave, imazhit të figurës, i pjesëmarrjes në aktivitete sportive, kulturore, kampionate si dhe të çdo aktiviteti të çfarëdolloj natyre për sportistë, trajnerë, si dhe përdorimi dhe/ose shitja apo dhënia në përdorim të përkohshëm të tyre.
- Organizimi i aktiviteteve sportive dhe kulturore.
- Shitje, blerje, prodhim, tregti me shumicë dhe pakicë i artikujve video dhe fotografie, aksesoreve, si dhe të çdo artikulli industrial.
- Aktivitete reklamimi.
- Zotërim i pasurive të paluajtshme, apo përdorim dhe menaxhim i tyre.
- Zotërimi menaxhimi, përdorimi ushtrimi i aktivitetit të agjencive publicitare, të agjencive të komunikimit, medias së shkruar apo radiotelevizive, portaleve *online* si dhe dhënia e shërbimeve të lidhura me to.
- Aplikimi, konkurrimi, përfitimi për grante, donacione, dhurata, financime, sponsorizime nga burime buxhetore, private, me karakter kombëtar apo ndërkombëtar.
- Zotërimi i kuotave, aksioneve, të drejtave, si dhe themelimi apo pjesëmarrja në aktivitete të ndryshme tregtare, persona juridikë, OJF.
- Dhënia e shërbime të mësipërme për llogari të palëve të treta, përfshirë këtu shërbime të organizimit administrativ, administrim aktiviteti sportiv dhe tregtar, marrja përsipër dhe menaxhimi i të drejtave kontraktore çfarëdo lloji për llogari të të tretëve, konsulencë dhe shërbime administrimi, financiare, strategjike, teknike sportive.
- Shoqëria mund të ushtrojë të gjitha aktivitetet e mësipërme për llogari të saj ose për llogari të të tretëve në bazë të kontratave përkatëse për dhënie shërbimi me këto palë.
- Shoqëria mund të hapë gjithashtu zyra dhe degë në çdo vend tjetër në botë ku do ta ketë të mundur, apo të ndër marrë të gjitha transaksionet tregtare, industriale, financiare, pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme të nevojshme, ose që do të konsiderohen të dobishme për arritjen e qëllimit të saj: mund të kontraktojë kredi dhe financim në përgjithësi, mund të zotërojë interesa, kuota/aksione dhe çfarëdolloj pjesëmarrje në kapitalet e shoqërive të tjera, përfshirë shoqëritë të cilat kanë objekt tjetër direkt apo indirekt.
- Përveç kësaj në përputhje me legjislacionin shqiptar, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet direkt ose indirekt që është rezultat ose lidhet direkt me objektin e mësipërm.

NENI 4

Selia e shoqërisë

4.1 Shoqëria ka selinë ligjore: Nr pasurie 27/6/11 nr 2109 Rep, nr 788 kol, Zona kadastrale 3292

NENI 5

Kapitali i shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga kontributi në para i ortakëve themelues të kësaj shoqërie në lekë. Kapitali themeltar i shoqërisë është 10.000 (dhjetemije) lekë dhe përbëhet nga 2 (dy) kuota.

Ofop sio

[Signature]

- 1) **Marlein Topciu** është zotërues i 1 kuotë me 50% pjesëmarrje në kapitalin e shoqërisë në vlerën 5000 Lek.
- 2) **Rudina Kastrati** zotërues i 1 kuotë me 50% pjesëmarrje në kapitalin e shoqërisë në vlerën 5000 Lek.

NENI 6

Kohëzgjatja e shoqërisë

Afati kohor i zhvillimit të aktivitetit është i papërcaktuar dhe fillon më rregjistrimin e saj në QKB.

NENI 7

Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshte vijon:

- 1- Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimmarrës
- 2- Administratorët – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë

Organizimi dhe funksionimi i këtyre oragneve është përcaktuar në statutin e shoqërisë. Shoqëria administrohet nga një Administrator, i cili do të zgjidhet pëe një afat 5 vjeçar, me të drejtë riemërimi. Administrator i Shoqërisë do të jetë **Znj. Rudina Kastrati**, e bija e Faton, e datëlindjes 22.03.1989, lindur në Shijak e banues në Durrës, rruga "Pavaresia", Plazh, Durres, identifikuar sipas ligjit me anë të Letërnjoftimit ID nr. .034068280.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrative, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga Administratori, I cili do të ushtrojë këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin ne fuqi.

NENI 8

Ortaku themelues mund të vendosi me vullnetin e tij, për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojë çdo lloj aktiviteti privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

NENI 9

Organizimi dhe funksionimi i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj do të bëhet në përputhje me deponizat e ligjit përkatës dhe statutit.

NENI 10



Ortaku detyrohet të ruajë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

NENI 11

Legjislacioni i aplikuar

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga Statuti i firmosur nga ortakët e Shoqërisë. Çdo gjë që nuk është parashikuar në Statut do të disiplinohet nga legjislacioni tregtar dhe nga depozita ligjore në fuqi

ORTAKU THEMELUES

Marleim Topciu

Marleim Topciu
~~Ufopaio~~

Rudina Kastrati

Rudina Kastrati
~~Kastri~~